



MESAZH I UEA-së ME RASTIN E DITËS NDËRKOMBËTARE TË PAQES, 21 SHTATOR 2026

Dita Ndërkombëtare e Paqes na kujton angazhimin tonë të përbashkët për mosdhunën, bashkëpunimin dhe ndërtimin e shoqërive më të drejta dhe më të barabarta. Paqja ndërtohet përmes marrëveshjeve ndërkombëtare, por edhe në klasat e shkollave, në komunitete, në familje, në vendet e punës...

Ndërtimi i paqes fillon me dialogun e hapur, për të krijuar besim dhe për të vendosur parime drejtësie që çojnë drejt pajtimit dhe rindërtimit të asaj që është shkatërruar. Ai nënkupton gjithashtu kërkimin e një baze të përbashkët për të trajtuar problemet e përbashkëta. Përmes dialogut, nëse e dëshirojmë këtë, mund t'i shndërrojmë dallimet në bashkëpunim dhe tensionet në besim.

Për ta arritur këtë qëllim, dimensionin gjuhësor është shumë i rëndësishëm. Në një dialog të vërtetë, të gjitha palët dëgjohen, njihen dhe kuptohen, pavarësisht nga prestigji, pushteti apo gjuha amtare. Të sigurosh që njerëzit të mund të shprehën, të mësojnë, të marrin pjesë në jetën publike dhe të ruajnë gjuhët dhe traditat e tyre – kjo do të thotë të njohësh dinjitetin njerëzor dhe të drejtën për të qenë pjesë e ndërtimit të përbashkët të shoqërisë.

Që nga viti 1908, Universala Esperanto-Asocio punon, nëpërmjet mjetit bashkues të Gjuhës Ndërkombëtare Esperanto, për ndërtimin e paqes, duke afruar njerëzit nga e gjithë bota në një ndjenjë të fortë solidariteti dhe mirëkuptimi të ndërsjellë. Në Kongresin e 111-të Botëror të Esperantos, të zhvilluar në Grac të Austrisë, nga 1 deri më 8 gusht 2026, esperantistët e mbledhur, në rezolutën e tyre përmbyllëse, shprehën keqardhjen për “prirjen e tanishme drejt ripolarizimit të botës në zona ndikimi, të cilat favorizojnë gënjeshtër, frikësimin dhe zgjidhjen e çekuilibrave përmes forcës dhe luftës, në vend të dialogut dhe respektimit të së drejtës ndërkombëtare”.

Pjesëmarrësit e kongresit shprehën gjithashtu “mbështetjen e tyre për rolin qendror të Kombeve të Bashkuara në bashkërendimin e bashkëpunimit ndërkombëtar për zhvillim të qëndrueshëm dhe u bënë thirrje shteteve anëtare [të OKB-së] që t'i sigurojnë asaj mjetet, kompetencat dhe mbështetjen politike të nevojshme për ta përbushur në mënyrë efektive këtë rol”.

Të frymëzuar nga ideali i Esperantos për bashkimin e popujve dhe të njerëzve në një dialog të drejtpërdrejtë, ne do të punojmë, në partneritet me Kombet e Bashkuara dhe UNESCO-n, për të ndërtuar një paqe të qëndrueshme midis të gjithë njerëzve të botës.